

FJALA E DEPUTETIT ILIR METAJ

E MARTË 1 NËNTOR 2022

Më vjen keq, por më duhet ta them që në fillim, ju lutem mos më ndërprisni gjatë fjalës sime! Në fakt, kisha një pyetje për ministren, sepse ndonjëherë për të qenë më i qartë me shifrat që jepen është metoda e krahasimit dhe kjo metodë të ndihmon për të kuptuar, për shembull, sa do të jetë mbështetja e qeverisë për rininë këtë vit apo për vitet e ardhshme dhe sa ka qenë para vitit 2013?

Ju keni siklet nga kjo që bëtë. Zonja kryetare, a mundet të mbahet qetësi! Është i vetmi komision, por në qoftë se ju keni komplekse për të ndërhyrë dhe vendosur rregull te kolegët tuaj, na e thoni edhe neve që ta dimë dhe të mos merremi më me këtë problem.